

Pyetjet dhe përgjigjet e bëra më shpesh

23 Mars 2020

Drejtoria Arsimore e Filadelfias e kupton se ka shumë pyetje në lidhje me mbylljen e shkollave të drejtorisë për shkak të COVID-19 (koronavirus). Një listë me pyetje të bëra më shpesh (FAQ) në lidhje me ushqimet e shëndetshme, dhënien e mësimit, mirëmbajtjen e ambienteve dhe tema të tjera që gjenden më poshtë.

Drejtoria arsimore, si shumë të tjerë në të gjithë vendin, vazhdon të punojë gjatë situatës të COVID-19 (koronavirus) për shkollat, familjet dhe komunitetin tonë. Ndikimi i koronavirusit në zonën e Filadelfisë, në bazë të udhëzimeve që po marrim nga Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë, është në zhvillim. Drejtoria është përqëndruar në mënyra të reja dhe krijuese, në të cilat mund të mbështesim nevojat e nxënësve dhe familjeve tona gjatë kësaj kohe. Përgjigjet tona për situatën dhe mund të ndryshojnë në bazë të informacioneve dhe udhëzimeve që marrim. Ne vazhdojmë të zhvillojmë më shumë mënyra për t'u shërbyer fëmijëve dhe familjeve.

Faleminderit për durimin tuaj kur ne na duhet kohë për të diskutuar gjërat për interesat më të mira të të gjithë fëmijëve. Kjo faqe do të azhurnohet rregullisht, kështu që e vizitoni më shpesh për informacionet më të fundit. Ju lutemi kujdesuni dhe qëndroni të shëndetshëm!

USHQIMI PËR STUDENTËT

A janë të shëndetshme ushqimet për nxënësit ndërsa shkollat janë të mbyllura?

Po. Drejtoria Shkollore e Filadelfias, disa shkolla Çarter, dhe "Philadelphia Housing Authority" janë duke bashkëpunuar me "City's Office of Children and Family" për të siguruar ushqime për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e Filadelfias në 80 zona në të gjithë qytetin. Dyzet e nëntë nga këto zona janë ndërtesa të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias.

Kush kualifikohet?

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për ushqim falas dhe nuk kërkohet ID.

Kur dhe ku mund t'i marrë?

49 zonat e vaktit të shpërndarjes së ushqimeve të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias do të jenë të hapura nga ora 9 e mëngjesit deri në mesditë dy ditë në javë (e Hënë dhe e Enjte). Familjet mund të marrin tre mëngjese dhe tre dreka në të njëjtën kohë (gjashtë vakte në total çdo ditë). Më shumë informacione në lidhje me të gjitha vendet e shpërndarjes së vaktit të ushqimit përfshirë edhe një hartë interaktive të vendeve të vaktit të ushqimeve mund të gjenden në philasd.org dhe phila.gov.

Si mund të dhuroj ushqime ose para për ushqime?

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është mirënjohëse për mbështetjen e jashtëzakonshme për të ndihmuar në sigurimin e ushqimit të shëndetshëm për nxënësit ndërsa shkollat janë të mbyllura. Ne kërkojmë që të gjitha ushqimet dhe dhurimet monetare për ushqim të drejtohen në Philabundance në philabundance.org.

MËSIMI DHE DHENIE MËSIMI JASHTË ZONES SE SHKOLLES

Si do të sigurojë Drejtoria mbështetje arsimore për nxënësit ndërsa shkollat janë të mbyllura?

Ne nuk mund të zëvendësojmë udhëzimet e personalizuara që mësuesit tanë ofrojnë në klasë. Mësimdhënia është një art dhe një shkencë. Duhet vite studimi në kolegje, mentorimi, kolegjaliteti dhe zhvillimi profesional për të përsosur praktikën mësimore. Ndërsa mësimi në klasë nuk mund të zëvendësohet, ne jemi plotësisht të përkushtuar të sigurojmë që çdo nxënës të ketë një mundësi të angazhohet në mësim ndërsa shkollat janë të mbyllura.

Drejtoria aktualisht po merr vendime dhe planifikime bazuar në udhëzime nga shteti dhe qeveritë federale. Ky udhëzim ndonjëherë ndryshon nga dita në ditë. Bazuar në udhëzimet më të fundit të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë dhe Departamentit të Arsimit të Sh.B.A-së, Drejtoria nuk po ofron udhëzime të detyrueshme, formale, të graduara për shkak të barazisë dhe konsideratave të teknologjisë. Nxënësit tanë kanë nivele të ndryshme të nevojave mësimore, të drejtën e internetit dhe teknologjisë, dhe përgjegjësi familjare ndërsa shkollat janë të mbyllura. Ky udhëzim sigurisht që mund të ndryshojë sipas situatave të evolimit të COVID-19 .

Sidoqoftë, Drejtoria Arsimore është akoma duke siguruar mbështetje arsimore opsionale për të gjithë nxënësit ndërsa shkollat janë të mbyllura. Ne jemi të përqëndruar në përpjekjen për të siguruar mbështetje arsimore që sa më shumë familje dhe fëmijë të kenë mundësi të përfitojnë nga sa të jetë e mundur. Tani për tani, ne kemi bërë në dispozicion Matematikën, Letërsi , Shkencat dhe Studimet Shoqërore, udhëzues për të mësuar (LG) për çdo nivel të klasës. Udhëzuesit janë në përputhje me fushat që u janë mësuar nxënësve tashmë gjatë këtij viti shkollor. Prindërit dhe nxënësit mund të zgjedhin ata që funksionojnë më mirë për ta. Të gjitha këto burime janë plotësuese të komunikimit dhe mbështetjes nga mësuesi / mësuesja e rregullt e fëmijës suaj.

A janë udhëzuesit e mësimit të detyrueshëm?

Jo. Udhëzuesit e të mësuarit janë opsionale, për përdorim personal dhe për t'i mbajtur nxënësit të angazhuar në mësim. Ata nuk do të vlerësohen dhe asnjë fëmijë nuk do të marrë kredi shtesë për plotësimin e tyre.

Si mund të marrë udhëzuesit e të mësuarit?

Të gjithë udhëzuesit e të mësuarit janë në dispozicion në internet në philasd.org. Thjeshtë klikoni në kutinë/vijën në krye të faqes. Paketa letre të Letërsisë dhe Manualët e mësimit të Matematikës janë gjithashtu në dispozicion në çdo vend të shpërndarjes së vaktit të ushqimit të Drejtorisë Arsimore. Fatkeqësisht, udhëzuesit për shkencat dhe studimet shoqërore kanë konsiderata për të drejtat e autorit që ne jemi duke vlerësuar aktualisht.

Udhëzuesit e Letërsisë dhe Matematikës përfshijnë mësim të përditshme që do të angazhojnë nxënësit për 10 ditë. Grupi tjetër i udhëzuesve do të jetë në dispozicion në internet të

Mërkurën, 25 Mars, dhe në vendet e marrjes së vakteve të ushqimit që fillojnë të Enjten, 26 Mars.

Po sikur fëmija im të ketë një IEP?

Nëse fëmija juaj ka një IEP, ju mund të përdorni udhëzuesit e të mësuarit si një burim. Ne ju rekomandojmë të zgjidhni udhëzuesin që është më i përshtatshmi për të përmbushur nevojat e fëmijës tuaj. Prindërit dhe kujdestarët e nxënësve me nevoja të veçanta që kanë pyetje më specifike mund të lidhen me një profesionist nga Zyra e Shërbimeve të Specializuara duke lënë një numër telefoni për personelin e Linjës Telefonike të Drejtorisë Arsimore.

A do të bëhen udhëzues të mësimit në gjuhë të ndryshme nga anglishtja?

Ndërsa udhëzuesit e të mësuarit nuk janë të disponueshme në shtyp në gjuhë të shumta, prindërit dhe kujdestarët e nxënësve që kanë nevojë për ndihmë me përkthime mund të lidhen me një përkthyes duke lënë një numër telefoni për personelin e Linjës Telefonike.

A janë mundësi të tjera arsimore për nxënësit që po eksplorojnë?

Po, është e rëndësishme të gjesh mënyra të reja për të zgjeruar dhe forcuar përvojën e mësimit në distancë për të gjithë nxënësit. Ne jemi duke zhvilluar një plan për të siguruar pajisjet mësimore të barabarta për të gjithë nxënësit. Ne do t'ju mbajmë të azhurnuar ndërsa planet tona përparojnë. Ne jemi gjithashtu në procesin e organizimit të trajnimeve dhe burimeve virtuale në mënyrë që më shumë mësues të mund të qëndrojnë të lidhur me nxënësit që përdorin Google Classroom.

A mundet që unë dhe fëmija im të komunikojmë akoma me mësuesit e fëmijës tim?

Absolutisht. Ne inkurajojmë shumë mësuesit tanë që të qëndrojnë të lidhur me nxënësit e tyre gjatë kësaj periudhe të mbylljes së shkollave. Mësuesit do të vazhdojnë të:

- inkurajojnë nxënësit përdorimin e Manualëve të Mësimit dhe promovojnë disponueshmërinë e tyre në internet dhe në vendet e shpërndarjes së vaktit të ushqimit të Drejtorisë Arsimore.
- postojnë / ndajnë burime shtesë të mësimit në internet me nxënësit dhe familjet që vetë-udhëzohen
- të jenë të disponueshëm përmes postës elektronike, telefonit, apo platformave të tjera (klasa Google, Infinite Campus, Class Dojo) për t'iu përgjigjur vullnetarisht nxënësve dhe familjeve pyetjet dhe mbështetur mësimin e tyre
- Sigurojnë që nxënësit të kenë akses në Portalin e Nxënësve, Google Classroom, email, dhe programe të zgjedhura në internet, ndërhyrje dhe shtesa kurrikulare

SI MUND TË KONTAKTOJ DREJTORINË NËSE KAM PYETJE TË PËRGJITHSHME GJATË MBYLLJES?

Po sikur të kem pyetje të përgjithshme në lidhje me Manualët e Mësimit ose mbylljen e shkollave?

Linjat telefonike në gjuhë të ndryshme funksionojnë të Hënën deri të Enjten në mëngjes nga ora 9:30 deri në 11:30 për t'iu përgjigjur pyetjeve të përgjithshme në gjuhët amtare të shumë prej familjeve tona.

215-400-5300 - Anglisht

215-400-8489 - Spanjisht

215-400-8480 - Shqip
215-400-8481 - Arabisht
215-400-8482 - Kineze
215-400-8483 - Frëngjisht
215-400-8484 - Khmer
215-400-8474 - Portugeze
215-400-8485 - Rusisht
215-400-8486 - Vietnamisht

Ju gjithashtu mund të dërgoni me email pyetjet tuaja në covid19info@philasd.org.

DITË TË HUMBURA PËR SHKAK TË KORONAVIRUSIT

A do të kërkohet nga Drejtoria Arsimore të zëvendësojë ditët e humbura si rezultat i mbylljes se shkollave?

Jo. Departamenti i Arsimit në Pensilvani ka vendosur që nuk do të penalizojë rrethet që nuk plotësojnë numrin minimal të kërkuar të ditëve ose orëve mësimore këtë vit shkollor për shkak të COVID-19. Ndërsa evoluon situata, ne do të ndajmë çdo azhurnim që kemi se si do të duket kalendari ynë për pjesën e mbetur të vitit.

TESTE TË STANDARDIZUARA DHE PROVIMET PËR HYRJË NË KOLEGJ

A do të behen akoma testet PSSA dhe provimet e Keystone?

Jo. Më 19 Mars 2020, Departamenti i Arsimit i Pensilvania (PDE) anuloi të gjitha testimet PSSA, Keystone dhe Pennsylvania Alternate of System of Assessment (PASA) për këtë vit shkollor si rezultat i COVID-19. Ju mund të gjeni informacionin më të fundit në lidhje me efektet e anulimit të testimit në www.education.pa.gov.

A do të ndodhin akoma testet SAT dhe ACT që ishin planifikuar për pranverën 2020?

Jo. Datat e provimit të SAT dhe ACT po ndryshojnë me shpejtësi, prandaj sigurohuni që të vizitoni <https://pages.collegeboard.org/natural-disasters> dhe <https://www.act.org/> për të gjetur informacionin më të fundit.

BURIMET PËR SHËNDETIN

Si mund të flas me fëmijët e mi për koronavirusin nëse ato tregojnë shënja stresi?

Me aq shumë informacion që ndahen për koronavirus, është e lehtë të ndjeheni të mbingarkuar. Këto dhe burime të tjera janë në dispozicion në seksionin e Burimeve të faqes në internet të Drejtorisë Arsimore në <https://www.philasd.org/coronavirus> për t'ju ndihmuar të flisni me fëmijën tuaj rreth koronavirusit dhe të menaxhoni çdo stres që mund të ndiheni ju ose të dashurit tuaj:

- Udhëzues për burimet e prindërve COVID-19 ([COVID-19 Parent Resource Guide](#))
- Duke folur me fëmijët Rreth Coronavirus ([Talking To Kids About The Coronavirus](#))
- Duke folur me fëmijët Rreth COVID-19: Një burim për prindërit ([Talking to Children About COVID-19: A Parent Resource](#))
- Përballimi me stresin gjatë sëmundjeve infektive ([Coping with Stress During Infectious Disease Outbreaks](#))